

**Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H**

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR**

**ME 31 DHJETOR 2020**

**(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)**

**Wind Power Albania Shpk**  
**Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me**  
**31 Dhjetor 2020**

**Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H**

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR**

**ME 31 DHJETOR 2020**

**(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)**

- 1 INFORMACION I PERGJITHSHEM
- 2 BAZAT E PERGATITJES
- 3 PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL
- 4 LLOGARI TE ARKETUESHME TREGTARE
- 5 AKTIVE TE QENDRUESHME TE TRUPEZUARA
- 6 AKTIVE TE PATRUPEZUARA
- 7 DETYRIME NDAJ FURNITOREVE
- 8 DETYRIME TE TJERA TATIMORE
- 9 TE ARDHURA
- 10 SHPENZIME TE TJERA
- 11 TATIMI MBI FITIMIN
- 12 PARIMI I VIJUESHMERISE
- 13 DETYRIME DHE ANGAZHIME JASHTE BILANCIT
- 14 NGJARJET PASUESE

**Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H**

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR**

**ME 31 DHJETOR 2020**

**(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)**

#### **INFORMACION I PERGJITHSHEM**

Shoqeria "Wind Power Albania Shpk ", eshte krijuar ne vitin 2017. Shoqeria identifikohet me numer NIPT-i: L72321028H dhe selia e saj ndodhet ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 12, Tirane, Shqiperi. Shoqeria ka capital te regjistruar ne vleren 10,000,000 leke, aksioneri i vetem i te ciles eshte Z. Besim Mulaj i cili zoteron 100% te aksioneve.

Shoqeria do te ushtroje aktivitet privat ne fushen e: Pjesemarrjes direkte ose indirekte ne te gjitha shoqerite apo ndermarrjet tregtare te sherbimeve industriale, energjitike (energji se eres, diellore, biomases etj) dhe financiare me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme. Kontrollin e administrimit te tyre ose pjesemarrjen ne te nepermjet marrjes se te gjitha mandateve ne gjirin e shoqerise apo ndermarrjeve ne fjale, Ajo mundet gjithashtu, nen rezerven e kufizimeve ligjore, te beje te gjitha operacionet tregtare, industriale, te luajtshme, te paluajtshme apo financiare qe lidhen direkt ose indirekt me objektin e saj shoqeror. Ajo mundet gjithashtu, te marre interesa me ane te kontributit, shkrirjes, nenshkrimet, nderhyrjes financiare ose ne çdo menyre tjeter, ne te gjitha shoqerite ose ndermarrjet ne Shqiperi apo jashte saj, qe kane plotesisht apo pjeserisht nje objekt te ngjashem apo te lidhur me te sajin apo qe mund te favorizojë zgjerimin dhe shtrirjen e saj..

Z.Besim Mulaj eshte edhe perfaqesuesi ligjor i shoqerise jne cilesine e administratorit te shoqerise.

Me 31 dhjetor 2020 numri I punonjesve ishte 1 (2019: 1 punonjes).

#### **BAZAT E PERGATITJES**

Pasqyrat financiare bashkelidhur jane pergatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), neperputhje me Ligjin Nr. 9228 date 29 prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (I ndryshuar).

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne parimin e vijueshmerise, e cila supozon qe Shoqeria do jete ne gjendje te shlyeje detyrimet.

Shoqeria ka njohur humbje ne shumen ne Lek 5063 per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020. Drejtimi ka nje prishmeri te arsyeshme qe Shoqeria ka burime te mjaftueshme per te vazhduar aktivitetin e saj operativ ne te ardhmen. Nese per ndonje arsye Shoqeria nuk eshte ne gjendje te funksionojë sipas parimeve te vijimesise, kjo mund te ndikojë ne aftesine e saj per terealizuar aktivitet me vleren e njohur, ne vecanti llogarite e arketueshme, si dhe te permbushe detyrimet per me shumate e deklaruar ne pasqyrat financiare me ane te aktivitetit. Duke qene shoqeri e krijuar me 21.11.2017 ajo eshte ne faze kerkimore dhe zhvillimore dhe investimi , kjo eshte edhe arsyeja qe shoqeria nuk ka realizuar te ardhura me 2020 por vetem shpenzime, pervec te ardhurave nga konvertimi pas rivleresimit te llogarive ne valute me 31.12.2020.

**Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H**

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR**

**ME 31 DHJETOR 2020**

**(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)**

### **BAZAT E MATJES**

Keto pasqyra financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike.

Monedha funksionale dhe raportuese

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne LEK, qe eshte monedha funksionale e Shoqerise.

### **PERDORIMI I VLERESIMEVE DHE GJYKIMEVE**

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon qe drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime, te cilat ndikojne ne zbatimin e politikave kontabel dhe ne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto supozime.

Vleresimet dhe supozimet e permendura rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhshme nese ato ndikohen.

Politikat kontabel te paraqitura ne vazhdim jane zbatuar ne menyre sistematike per te gjithë periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare.

### **PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL**

Politikat kontabel te paraqitura me poshte, jane zbatuar ne menyre te qendrueshme pergjate gjithë periudhave te paraqitura ne keto pasqyra financiare.

### **TRANSAKSIONET NE MONEDHETEHUAJ**

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare te regjistruara ne monedha te huaja ne daten e bilancit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te asaj date.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare te regjistruara ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

Diferencat nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi njihen ne pasqyren e te ardhurave.

**Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H**

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR**

**ME 31 DHJETOR 2020**

**(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)**

### **AKTIVET E QENDRUESHMETETRUPEZUARA**

Aktive te qendrueshme te trupezuara maten me kosto minus amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga renia ne vlere, nese ka. Kosto perfshin shpenzime qe lidhen direkt me blerjen e aktivitet

### **AKTIVET E PATRUPEZUARA**

Aktivitet e patrupëzuara që janë blerë nga Shoqëria janë paraqitur me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Amortizimi njihet duke perdorur metoden e llogaritjes mbi vleren e mbetur duke perdorur normat e amortizimit si me poshte:

Mobiljedheorendi	20%
Pajisje	15%
Paisjezyre (kompjuterike& software)	25%

### **INSTRUMENTAFINANCIARE**

Shoqeria mban vetem instrumenta financiare jo derivative, qe perfshijne mjete monetare dhe ekuivalente me to, llogarite e arketueshme tregtare, llogarite e pagueshme, dhe te tjera kerkesa dhe detyrime.

Nje aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transakcionit qe i perkasin drejtperdrejt blerjes ose emetimit te atij instrumenti financiar dhe me pas matet me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Ne fund te cdo periudhe raportuese Shoqeria vlereson nese ka ndonje evidence objektive qe nje aktiv ose grup aktivesh financiare kapatur renie ne vlere. Nese ekziston nje evidence e tille, aktivi financiar zhvleresohet deri ne vleren aktuale te flukseve te ardhshme te parave, te skontuara me normen efektive fillestare te interesit. Humbjet nga renia ne vlere njihen si shpenzime ne pasqyren e teardhurave.

### **TATIMI MBI FITIMIN**

Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin bazohet ne shumen e tatimit te pagueshem sipas legjislacionit Shqiptar, sic eshte percaktuar nen kerkesat rregullatore kontabel ne Shqiperi, duke perdorur normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si dhe cdo rregullim tjeter ne tatimin e pagueshem te viteve te meparshme. Shoqeria ka zgjedhur qe te mos aplikojte SKK 11 "Tatimi mbi fitimin" ne lidhje me njohjen e tatimeve te shtyra

Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR**

**ME 31 DHJETOR 2020**

(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)

**LLOGARI TE ARKETUESHMETREGTARE**

Shoqeria ka paraqitur ne llogari te tjera te arketueshme TVSH-ne e kreditueshmesi me poshte

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
TVSh e kreditueshme	1,168	1,168
	<b>1,168</b>	<b>1,168</b>

**AKTIVE TE QENDRUESHME TE TRUPEZUARA**

Shoqeria nuk posedon aktive te qendrueshme te trupezuara me 31 dhjetor 2020.

**AKTIVE TE PATRUPEZUARA**

Gjithashtu shoqeria nuk posedon aktive te qendrueshme te patrupezuara me 31 dhjetor 2020.

**DETYRIME NDAJ FURNITOREVE**

Shoqeria nuk ka detyrime ndaj furnitoreve me 31.12.2020.

**DETYRIME TE TJERA TATIMORE**

Detyrimet e tjera tatimore perfshijne:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Detyrime per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	229,467	142,419
Detyrime tatimore per te ardhurat personale		
	<b>229,467</b>	<b>142,419</b>

**9 TE ARDHURA**

Shoqeria nuk ka realizuar te ardhura per vitin e mbyllur ushtrimor 31 Dhjetor 2020 pervec te arshurave nga konvertimi I rivleresimit te llogarive ne valute me kursin e dates 31.12.2020 si me poshte ne vleren 359,041 leke:

**Euro 123.7 Leke**

**USD 100.84 Leke**

Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR  
ME 31 DHJETOR 2020**

(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)

**10 SHPENZIME TE TJERA**

Shpenzime per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2019 jane te detajuara si me poshte:

Pagat e personelit	312,000
Shpenzime per sigurimet shoqerore	<u>52,104</u>
	<b><u>364,104</u></b>

**11 TATIMI MBI FITIMIN**

Tatimi per fitimin per korporatat eshte I pagueshem ne normen 15% (2019: 15%) mbi fitimin neto te periudhes te rregulluar per qellime tatimore ne perputhje me legjislacionin tatimor ne Shqiperi. Nje kuadrim I fitimit kontabel dhe fitimit te tatueshem eshte I detajuar me poshte:

	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2020	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2019
Humbja para tatimit	(5,063)	(936,201)
Plus: Shpenzimet e pazbritshme		
Humbja e tatueshme per vitin	<b>(5,063)</b>	<b>(936,201)</b>
Tatimi mbi fitimin per periudhen	-	-
Taksa te pagueshme, fillimi I vitit		
Tatimi I kompensuar gjate vitit		
Tatimi I parapaguar ne fund te vitit		

Shoqeria ka vendosur te mos njohe tatim te shtyre, dhe perkatesisht nuk ka njohur as aktiv tatimor te shtyre ne lidhje me humbjen e tatueshme, per te cilen nuk ka siguri per gjenerimin e fitimit tatimor te mjaftueshem perpara skadences se humbjeve te cilat mbarten deri ne tre vite nga gjenerimi I humbjes.

**12 PARIMI I VIJUESHMERISE**

Shoqeria ka rezultuar me humbje per vitin 2020 ne shumen 5,063 Lek(2019:936,201Lek ) duke qene se shoqeria eshte ne fazen fillestare te investimit , hulumtimit te tregut etj, pasi

**Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H**

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR**

**ME 31 DHJETOR 2020**

**(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)**

shoqeria eshte krijuar me 21.11.2017. Gjithsesi pasqyrat financiare jane hartuar mbeshtetur ne parimin e vijueshmerise, pra qe ne te ardhmen keto humbje do tembulohen nga flukset e te ardhurave qe do te gjenerohen ne periudhat e ardhme.

#### **DETYRIME DHE ANGAZHIME JASHTE BILANCIT**

Shoqeria nuk ka detyrime dhe angazhime jashte bilancit per vitin e mbyllur ushtrimor 2020.

#### **NGJARJE PASUESE**

Shoqeria nuk ka ngjarje pasuese qe mund te kene efekt ndryshimi ne pasqyrat financiare per vitin e mbyllur ushtrimor 2020.

**PER SHOQERINE "WIND POWER ALBANIA " SHPK**

**ADMINISTRATORI**

**BESIM MULAJ**

**Wind Power Albania ShpkNipt: L72321028H**

**SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR**

**ME 31 DHJETOR 2020**

**(Shumat ne Lek, pervecse kur permendet ndryshe)**